



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2024

Lënda: Rekomandim mbi marrjen e masave për shmangien e kritereve diskriminuese, për sa i përket kriterit të e notës mesatare të studimeve pararendëse, të diferencuar midis shkencave natyrore e teknike (mbi 9) dhe shkencave ekonomike e shoqërore (mbi 9.5), të vendosur në kuadër të Fondit të Ekselencës.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Rruga e Durrësit, nr.23

Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar (LMD), përcaktohet se:

"Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin".

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja "c", të LMD-së, ku përcaktohet se: *"Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji"*, Komisioneri, në ushtrim të kompetencës që i jep LMD, me Urdhrin nr. 94, datë 29.06.2021, ka filluar procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes mbi kriterin e notës mesatare të studimeve pararendëse, të diferencuar midis shkencave natyrore e teknike (mbi

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

9) dhe shkencave ekonomike dhe shoqërore (mbi 9.5), të vendosur në kuadër të Programit të Fondit të Ekselencës.

I. Parashtrimi i fakteve lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave për shqyrtimin e ankesave nga ana e personave të cilët pretendojnë se janë diskriminuar, Komisioneri është vënë në dijeni të faktit se, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.160, datë 19.02.2020 “*Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)*” vendos kritere diferencuese në lidhje me notën mesatare të kërkuar, për studentët ekselentë që duan të përfitojnë, në bazë të llojit/profilit të diplomës. Konkretisht, në pikën 2, germa “ii”, të kësaj VKM-je, për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë për shkencat natyrore dhe teknike, nota mesatare e kërkuar është mbi 9, ndërsa për ata që kanë përfunduar të njëjtin cikël studimesh por për shkencat ekonomike e shoqërore, nota mesatare e kërkuar është mbi 9.5. Rezulton se, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.483, datë 16.07.2014, “*Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)*”, i cili aktualisht është zëvendësuar me VKM-në e sipërcituar, bënte të njëjtin parashikim.

Bazuar në dispozitat e ligjit nr.80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe veçanërisht në nenin 4, nenin 6, pika 3 dhe nenin 112, pika 4, ligji, nuk parashikon ndonjë diferencë në trajtim në lidhje me mundësinë për të përfituar bursë, bazuar në llojin apo profilin e diplomës, nëse është në shkencat natyrore/teknike apo në shkencat ekonomike e shoqërore.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.992/1 prot., datë 07.07.2021, Komisioneri i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ka kërkuar informacionin e mëposhtëm:
 - Cili është qëllimi për këtë trajtim të diferencuar dhe mbi çfarë bazash janë vendosur kritere të ndryshme në lidhje me notën mesatare të kërkuar mbi 9, për shkencat natyrore teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore, për studentët të cilët duan të përfitojnë nga fondi i ekselencës, sipas parashikimeve të pikës 2, germa “ii”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.160, datë 19.02.2020 “*Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)*”?

- Kopje të akteve/konstatimeve/raporteve apo studimeve mbi të cilat është bazuar vendosja e kriterit të mësipërm në lidhje me notën mesatare.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit depozitoi pranë KMD-së parashtrimet e saj me shkresën nr.3870/1 prot., datë 31.08.2021, duke informuar se:

Lidhur me mbështetjen financiarë të studenteve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civile (Fondi i Ekselencës) të cilët përmbushin kriterin e notes mesatare mbi 9 për shkencat natyrore dhe teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike dhe shoqërore, sqarojmë se diferencimi i mesatares së studimeve pararendëse në varësi të fushës është vendosur për herë të parë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 27.04.2007" *Për fondin e ekselencës për mbështetjen financiare të studenteve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer*", i ndryshuar.

Nga të dhënat e mbledhura për periudhen 2014-2020, rezulton se, pavarësisht përcaktimit të notës mesatare minimale mbi 9 për kandidatët të cilët kishin përfunduar studimet e ciklit të parë në shkenca natyrore dhe teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike dhe shoqërore, për studentet që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare, nga Fondi i Ekselencës janë mbështetur financiarisht një numër me i lartë studentësh për ndjekjen e programeve të ciklit të dytë në fushën e shkencave natyrore dhe teknike. Kjo e dhënë tregon se përcaktimi i notës mesatare më favorizuese për studentët e shkencave natyrore dhe teknike ka qenë domosdoshmëri që të parandalonte apo frenonte krijimin/thelimin e hendekut tejet të madh midis numrit të studenteve të financuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në shkencat shoqërore dhe ekonomike në raport me studentët e shkencave natyrore dhe teknike.

Sqarojmë gjithashtu se diferencimi i notës mesatare lidhur me financimin e studentëve shqiptare për kryerjen e studimeve jashtë vendit në kuadër të Fondit të Ekselencës, ka qenë politikë e hershme e ministrisë përgjegjëse për arsimin, duke u vendosur si kriter që në vitin 2007, që përkon me krijimin e Fondit të Ekselencës dhe nga viti 2009 e në vijim, duke diferencuar notën mesatare në bazë të fushës së studimeve pararendëse. Bazuar në të dhënat e përfituesve të Fondit të Ekselencës ndër vite, rezulton se diferencimi i mesatares së studimeve në varësi të fushës së studimeve, ka qenë një politike e mbështetur në analizën e regjistrimeve dhe diplomimeve në arsimin e lartë dhe prioriteteve të vendosura nga MASR në lidhje me fushat e studimit.

Për sa u parashtrua me sipër, si dhe duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës në vend, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë vlerëson se aplikimi si kriter të notës mesatare të diferencuar mbi bazën e fushës së studimeve pararendëse me qëllim përfitimin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civile (Fondi i Ekselences) është përligjur dhe nuk përbën diskriminim, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave nuk depozitoi pranë Komisionerit informacion dhe/ose parashtrime në lidhje çështjen e adresuar.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 57

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.
2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.
3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.
4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.
5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.
6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.
7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.10221/2010)

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.
2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 6

Trajtimi i ndryshëm i përligjur

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

Neni 17

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;

b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;

c) përmbajtjen e parimeve dhe kriterëve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;

ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.80/2015)

Neni 4

E drejta për arsimim

1. Të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë e kanë të gjithë ata individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi dhe nga institucionet e arsimit të lartë.

2. Shteti garanton arsimimin edhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato.

3. Arsimi u garantohet në këto programe studimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.

4. Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 6

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Bursa” është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kritereve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 112

Granti i mësimdhënies

1. Granti i mësimdhënies përfshin:

- a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) fondin e mbështetjes studentore.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule që garanton mundësi të barabarta, drejtësi dhe transparencë.

3. Fondi i mbështetjes studentore përfshin tri kategori financimi:

- a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;
- b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;
- c) bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.

5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t’u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Ky grant shpërndahet nga AKFAL-i.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.160, datë 19.02.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)” (në vijim VKM nr.160/2020) i ndryshuar.

1. Financimin nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës për Fondin e Ekselencës, dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme, për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga ministria përgjegjëse për arsimin për bursa për:
 - a. Studentët, të cilët ndjekin studimet e ciklit të dytë apo të tretë jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës;
 - b. Nëpunësit civilë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:
 - a. Studentët, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë kur:

.....
ii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore;

IV. Arsyetimi ligjor

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit përshkon edhe nenin 57, të Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën për arsim.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivist të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Sipas GJEDNJ-së, "diskriminim i drejtpërdrejtë" është një "ndryshim në trajtimin e personave në situata të njëjta ose të ngjashme" që "bazohet në një

karakteristikë të identifikueshme ose "status/shkak" të mbrojtura nga Neni 14 i Konventës"³. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁴. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga neni 14 i KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme (diskriminimi i tërthortë)⁵.

Bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe informacionit të administruara, rezultoi se:

Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil ose ndryshe Fondi i Ekselencës është krijuar në vitin 2007 bazuar në Vendimin e këshillit të Ministrave nr.225, datë 27.04.2007 "Për fondin e ekselencës, për mbështetjen financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer". Rezulton se, që prej krijimit të tij, Fondi i Ekselencës ka vendosur një diferencim në mesataren e studimeve pararendëse në varësi të fushës, konkretisht nota mesatare mbi 9 për shkencat natyrore dhe teknike dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike dhe shoqërore. Rezulton se i njëjti diferencim i notës mesatare në bazë të fushës së studimeve pararendëse, ka vijuar.

Rezulton se aktualisht Fondi i Ekselencës, rregullohet bazuar në VKM nr.160, datë 19.02.2020 "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)", i ndryshuar. Në pikën 2, gërma "a", pika "ii", rezulton se ky akt nënligjor vazhdon të bëjë të njëjtin diferencim në lidhje me notën mesatare sipas fushës së studimit, duke përcaktuar shprehimisht se: "Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon: a) Studentët, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë kur:.....ii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore;"

VKM nr.160/19.02.2020, të ndryshuar, është një akt nënligjor i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të neneve 4, pika 4 dhe 112, pika 4, të ligjit nr.80/2015.

Sipas pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, shteti garanton arsimimin edhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë

³ GJEDNJ: *Biao kundër Danimarkës* [GC], 2016; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 2010; *Varnas kundër Lituaniës*, 2013.

⁴ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁵ GJEDNJ: *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (Nr. 34369/97), 6 Prill 2000.

financiare për t'i përballuar ato. Ligji i sipërcituar, ka autorizuar Këshillin e Ministrave për të nxjerr atë nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë.

Pika 4, e nenit 112, që ka shërbyer si bazë ligjore për miratimin e VKM nr.160/19.02.2020, përcakton se, bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet.

Ligji nr.80/2015, përcakton se, “Bursa” është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kritereve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin objekt shqyrtimi, mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil ose ndryshe Fondi i Ekselencës, është një bursë e cila jepet mbi bazën e arritjeve akademike të studentit.

Ligji nr.80/2015, i cili përbën bazën për dhënien e mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë ose Fondin e Ekselencës, nuk bën asnjë diferencim midis fushave të studimit. Përkundrazi, neni 112, pika 4, e ligjit nr.80/2015, përcakton se, bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Në këtë mënyrë konstatohet se diferencimi që bëhet në lidhje me kriterin e notës mesatare në varësi të fushës së studimit, nuk është një diferencim që rrjedh nga ligji, por nga akti nënligjor, VKM nr.160/19.02.2020.

Komisioneri vëren se, *prima facie*, parashikim i pikës 2, gërma “a”, pika “ii”, në VKM nr.160/19.02.2020, vendos një diferencë në trajtim, midis studentëve që kanë ndjekur studimet për shkencë natyrore dhe teknike dhe studentëve që kanë ndjekur studimet në fushën e shkencave ekonomike e shoqërore, duke trajtuar në mënyrë më pak të favorshme studentët e shkencave ekonomike e shoqërore, të cilëve iu kërkohet një notë mesatare më e ulët (9) krahasimisht me studentët që kanë ndjekur studimet në fushën e shkencave natyrore dhe teknike, të cilëve iu kërkohet një notë mesatare më e lartë (9.5). Për rrjedhojë, dukshëm diferencimi që bëhet nga dispozita e analizuar, bazohet vetëm në fushën e studimit, ndodhur në të njëjtat kushte e rrethana faktike.

Rezulton se, diferencimi i mesatares së studimeve pararendëse në varësi të fushës së studimit, midis fushës së shkencave natyrore dhe teknike dhe shkencave ekonomike dhe shoqërore, ka ekzistuar që prej momentit të krijimit të Fondit të Ekselencës në vitin 2007, ka vijuar të qëndrojë i njëjtë dhe është aktualisht i pandyshuar. Arsyet e pretenduara nga MAS të cilat përlligjin diferencimin e notës mesatare në varësi të fushës së studimit, janë si më poshtë:

- Diferencimi i notës mesatare lidhur me financimin e studentëve shqiptarë për kryerjen e studimeve jashtë shtetit, në kaudër të Fondit të Ekselencës, ka qenë politikë e hershme e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- Diferencimi i mesatares së studimeve në varësi të fushës së studimeve, ka qenë një politikë e mbështetur në analizën e regjistrimeve dhe diplomimeve në arsimin e lartë dhe prioritetet e vendosura nga MASR, në lidhje me fushat e studimit.
- Diferencimi i mesatares së studimeve në varësi të fushës së studimit është bërë duke mbajtur parasysh nevojat e tregut të punës.

MAS nuk vendosi në dispozicion se cilat kanë qenë arsyt fillestare që kanë diktuar nevojën për vendosjen e një diferencimi në notën mesatare midis shkencave natyrore dhe teknike dhe shkencave ekonomike dhe shoqërore. Komisioneri vlerëson se, fakti diferencimi i notës mesatare në varësi të fushës së studimit ka qenë një politikë e hershme e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit, do të thotë se, kushtet apo nevoja mbi bazën e të cilave ky diferencim është vendosur potencialisht mund të kanë ndryshuar.

MAS, informoi se, nga të dhënat e mbledhura për periudhën 2014-2020, rezulton se, nga Fondi i Ekselencës janë mbështetur financiarisht një numër më i lartë studentësh për ndjekjen e programeve të ciklit të dytë në fushën e shkencave natyrore dhe teknike. Sipas MAS, kjo e dhënë tregon se, përcaktimi i notës mesatare më favorizuese për studentët e shkencave natyrore dhe teknike ka qenë domosdoshmëri që të parandalonte apo frenonte krijimin/thelimin e hendekut tejet të madh midis numrit të studenteve të financuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në shkencat shoqërore dhe ekonomike në raport me studentët e shkencave natyrore dhe teknike.

MAS, nuk vendosi në dispozicion asnjë të dhënë e cila të mbështesë pretendimin e saj se, ka patur një hendek tejet të madh midis numrit të studentëve të financuar për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në shkencat shoqërore dhe ekonomike në raport me studentët e shkencave natyrore dhe teknike. Megjithatë Komisioneri nuk e vlerëson të bazuar këtë pretendim edhe për faktin se, ka qenë hendeku i pretenduar midis numrit të studentëve të financuar për ndjekjen e studimeve në shkencat shoqërore dhe ekonomike dhe atyre të shkencave natyrore dhe teknike arsyeja e diferencës në trajtim, pasi diferencimi në lidhje me notën mesataren në varësi të fushës së studimit është vendosur që prej krijimit të Fondit të Ekselencës.

MAS, pretendoi se, diferencimi i notës mesatares në varësi të fushës së studimeve, ka qenë një politikë e mbështetur në analizën e regjistrimeve dhe diplomimeve në arsimin e lartë dhe prioritetet e vendosura nga MASR, në lidhje me fushat e studimit dhe se janë mbajtur parasysh nevojat e tregut të punës, por nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit të dhënat konkrete ku bazohet diferencimi. MAS nuk vendosi në dispozicion të dhënat në lidhje me analizat e regjistrimeve dhe diplomimeve në arsimin e lartë, cilat janë dhe ku janë përcaktuar prioritetet në lidhje me fushat e studimit, si dhe të nevojat e identifikuar të tregut të punës, të cilat kanë

shërbyer si arsye për vendosjen e diferencimit në lidhje me notën mesatare në varësi të fushës së studimit.

Me Vendimin Nr.386, datë 01.06.2022 *“Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer, e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”*⁶, Këshilli i Ministrave, ka miratuar fushat dhe programet e studimit të cilat përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë. Referuar këtyre përcaktime, konstatohet se fushat e gjera të studimit të cilat janë përcaktuar si prioritare janë : “Arte dhe humanizëm”, “Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë”, “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim”, “Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinarri”, dhe “Shërbime”. Sa më sipër rezulton se, edhe pse këto fusha prioritare kanë të bëjnë me mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në vend, konstatohet se, prioritet nuk janë shpallur vetëm fusha që i përkasin shkencave natyrore dhe teknike, por edhe shkencat shoqërore dhe ekonomike. Nga ana tjetër, kjo VKM, nuk vendos diferencime në lidhje me notën mesatare sipas fushës së studimit që studenti duhet të plotësojë për të përfituar mbështetjen financiare. Në pikën 2, të VKM nr.386/01.06.2022, përcaktohet se: *“2. Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) Studenti me notë mesatare në pranim, që: i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00. b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin; c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.”*

Trajtimi i diferencuar është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Bazuar në nenin 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.
- I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe
- Në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

⁶ Ndryshuar me VKM nr. 397, datë 29.6.2023.

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjete e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”

Komisioneri vlerëson se, arsyet e pretenduara nga MAS se përlijin diferencën në notën mesatare në varësi të fushës së studimit, midis shkencave natyrore dhe teknike dhe shkencave shoqërore dhe ekonomike, parimisht përbëjnë arsye të ligjshme, por ato nuk rezultuan të provuara. Në kushtet, Komisioneri nuk arriti të identifikojë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për diferencën në trajtim në lidhje me notën mesatare midis fushës së shkencave natyrore dhe teknike dhe fushës së shkencave shoqërore dhe ekonomike, përcaktuar nëpërmjet VKM nr.160/19.02.2020, pika 2, gërma “a”, pika “ii”.

Sa më sipër, me qëllim rregullimin e situatës, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, shkronjën “f”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON:

1. Marrjen e masave për rishikimin e Vendit të Këshillit të Ministrave Nr.160, datë 19.02.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, të ndryshuar, duke eliminuar diferencën në trajtim në lidhje me notën mesatare midis shkencave natyrore e teknike dhe shkencave shoqërore dhe ekonomike.
2. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijani, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Punoi: K. Keta
Pranoi: V. Bushati
Datë: 30.04.2024